




PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS TE AKTIVITETIT

“Instalim per mbareshtimin intensiv te pulave”



Subjekti: Fermer-Boris Allmuça

Aktiviteti : Instalim per mbareshtimin intensiv te pulave

Hartoi : « Eko-Studio-Projekt » sh.p.k

Administratori: Shkelzen MADANI



Tirane, 2019



PERMBAJTJA

- + Hyrje
- + Baza ligjore
- + Metodika e vleresimit te mjedisit
- + Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT
2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI
3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVENE MJEDIS
4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktojne probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Instalim per mbarshtimin intensiv te pulave”

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedis te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 10 266 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ **Profili i propozuesit**

Operatori **Fermer Boris Allmuça** me adrese kryesore **Baldushk** dhe numer identifikimi Nipt **L92102451L**, sipas Certifikates per vertetimin pronesie e leshuar nga Z.V.R.P.P Tirane me Nr. Pasurie 32/9, Volumi 3, Faqe 151, Zona Kadastrale Nr. 2736 Operatori i lartepemendur zoteron nje pasuri te tipit are me siperfaqe totale 2080 m². Zhvilluesi do te kryeje aktivitetin e mbarshimit intensiv te pulave.

Qellimi i projektit

Qellimi i ketij aktiviteti eshte mbarshimi intensiv i pulave. Mbarshimi dhe rritja e tyre do te behet ne nje kaponon i cili do ndertohet me qellim shfrytezimi per aktivitetin e sipercituar. Kapanoni do te jete i standartizuar dhe do te kete instalime te nevojshme per rritjen dhe mbarshimin intensiv te pulave. Siperfaqja ne te cilin do te ndertohet ky kaponon dhe do te ngrihet ky zhvillim do te jete 2080 m² ne fshatin Mumajes. Zhvilluesi disponon te gjithe kapacitetin e nevojshem per zhvillimin e ketij aktiviteti.

Vendndodhja

Adresa ne te cilen do te ngrihet instalimi eshte Mumajes, Baldushk.

Projekte te tjera qe do ti vijne ne ndihme aktivitetit

Per zhvillimin e aktivitetit nuk do te kete projekte te tjera sepse infrastruktura rrugore eshte e ndertuar, gjithashtu nuk do jete e nevojshme ndertimi i kapononeve qe do ti vijne ne ndihme operatorit si ne fazen e ndertimit ashtu edhe ne fazen e operimit. Punonjesit do te meren nga zona perreth ose do te kryehet transporti privat nga kompania e ndertimit qe do kryeje punimet. Gjate fazes se operimit do te punesohen punonjes te zones perreth, duke sjelle keshtu edhe nje rritje ekonomike te zones ne fjale.



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

Pershkrimi i etapave per rritjen e zogjve

Njohja me ambientin me te cilen rritet zogu

Ambienti me te cilin do te rriten zogjte do te sherbeje nje kapanon i standartizuar i cili do te ndertohet posacerisht per kete zhvillim. Ai do te jete ne kushte shume te mira, gjithashtu do te kete te gjithe kapacitetin e nevojshem dhe hapsiren e mundshme per zhvillimin e ketij aktiviteti. Kapaciteti i rritjes se zogjve eshte mbi 20.000 krere zogj. Per te plotesuar kushtet per rritjen e zogjve ne lokale eshte vendosur nje impiant uji i perbere nga tre linja uji, nje impiant per ushqimin e zogjve i perber nga 2 linja ushqimi te kompletuara me pjata dhe me panelin e komanduar automatik, tre linja me ndricues, ventilatoret per qarkullimin e ajrit , aparati i matjes se temperatures dhe paneli elektrik i kontrollit me anen e te cilit behet komandimi ne menyren e duhur e te gjitha proceseve.

Pergatitja e lokalit per prritjen e zogjve

Etapa e pare e pergatitjes se lokalit eshte pastrimi i tij nga mbetjet (plehu) e tufes se pare, me pas behet larja e lokalit, proces te cilit i kushtohet nje rendesi e vecante. Lokali pasi eshte pastruar dhe lare lihet te thahet per disa dite, me pas behet izolimi mbyllja e dritareve, dyerve, aspiratoreve ne menyre qe dizinfektimi te behet sa me mire dhe te japi rezultate sa me pozitive. Pasi kane mbaruar keto procese behet dezinfektimi i ambientit ne menyre te imtesishme dhe ne sasine e duhur te dizinfektantit dhe lokali lihet i mbyllur per 24 ore.

Pritja e zogut

Duke u mbeshtetur dhe ne kushtet klimaterike hapja e lokalit behet 1 ose 2 dite para mberritjes se zogut. Gjate kesaj kohe behet ngrohja e lokalit me ane te ngroheseve pergatitja e rrethakeve dhe vendosja e piresve te ujit dhe kupave te ushqimit brenda ne rrethak. Gjithashtu behet larja e linjave te ujit dhe me pas ato lihen te mbushura me uje me sode gje e cila ndihmone ne pastrimin e linjave te ujit dhe ne heqjen e mbeturinave.

Pershtatja e aparaturave sipas moshes se zogjve

Ne ditet e para zogu ushqehet si e permendem me sipër me pas rreth dites se 3 zogu hiqet nga rrethakja dhe uji thithet ne menyre automatike me ane te linjave te ujit duke lene dhe disa pires shtese ndersa zogu te mesohet te pije uje ne linja. Menyra e ushqimit vazhdon e njejte si ditet e pare deri ne moshen 10-15 ditesh, me pas vendosen linjat automatike te ushqimit. Pra zogu ushqehet sipas dshires. E rendesishme ne rritjen e tyre eshte temperatura dhe ventilimi.



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

Pergatitja e ushqimit dhe perberesit kryesor te tij

Nje pike e rendesishme ne realizimin me sukses te kesaj veprimtarie eshte edhe ushqimi. Perberesit kryesor jane misri dhe soja. Rreth 80 % te ushqimit e perben misri, soja perben 28 % dhe pjesa tjeter perbehet nga vaji, karbonat dhe nukleusi qe i nevojitet zogut per te marr sasine e duhur te proteinave, energjise dhe gjithcka qe i nevojitet per nje rritje pa probleme. E rendesishme nuk eshte vetem perberja e ushqimit por edhe madhesia e kokrres se ushqimit. Ne periudhen e pare deri ne 21 dite kokrra e ushqimit duhet te jete shume e vogel, me pas ushqimi behet me i ashper ne menyre qe zogu mund ta konsumoj pa probleme.

Rregullat per mbrojtjen nga faktoret e jashtem

Rendesi e vecante i kushtohet mbrotjes nga faktoret e jashtem per kete perdoret ajo qe quhet karantine, domethen nuk lejohet kalimi i punetoreve dhe materialeve te ndryshem nuk lejohet hyrja e makinave te huaja ne territorin e kompleksit. Makinat perpara se te futen ne kete ambient u behet nje dezinfektim me sperkatje.

Programi i mbareshtimit te zogjve

Zogjte mbareshtrohen sipas nje programi zooteknik-veterinar te perpiluar nga specialiste perkates. Ky program mbeshtet ne keto pika:

- Normat eventilimit te lokalit
- Normat e ushqimit sipas fazes se rritjes se zogjve
- Pershtatja e temperatures sipas moshes se zogjve
- Programi i vaksinimeve. Me ane te vaksinimit parandalohen semundjet kryesore qe qarkullojne.
- Perdorimi i medikamenteve te ndryshme, me ane te te cileve luftohen infeksionet e mundshme.



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Pershkrim i faktoreve klimatike

Faktoret e formimit te klimes grupohen ne faktore kozmike, planetare (Tokesore) dhe lokale. Ne grupin e pare hyjne karakteristikat e qendrueshme ose te ndryshueshme te Diellit dhe te hapesires kozmike, ne grupin e dyte karakteristikat e te gjithë siperfaqes se tokes dhe te atmosferes, kurse ne grupin e trete karakteristikat e qendrueshme ose te ndryshueshme te ajrit dhe te tokes se vendit ne fjale. Ne teresine e faktoreve klimeformues eshte e veshtire te behet nje renditje e sakte , per arsye se secili prej tyre ndikon vazhdimisht ne formimin e klimes, nderkohe qe roli dhe rendesia e tyre eshte e ndryshueshme ne vende te ndryshme. Ne rast se do te benim nje fare renditje, atehere ne radhe te pare duhet te vendosim rrezatimin diellor, sepse sasia dhe intensiteti i tij percaktojne karakteristikat themelore te klimes.ndikim te madh ne klimen e vendit tone kane detet Adriatik dhe Jon. Deti Adriatik duke qen i rrethuar nga Gadishulli i Ballkanit dhe i Apenineve eshte relativisht i ftohte dhe per kete arsye roli i tij zbutes mbi klimen eshte me pak i ndjeshem sesa i detit Jon . deti Jon duke qen i hapur nga jugu , rrihet me teper nga ererat e .ngrohta te Afrikes , ky det i jep klimes te Shqiperise nje karakter edhe me te theksuar mesdhetar.

Klima e zones

Ajri eshte me lageshti mesatare 60-80%. Persa i perket cilesise se ajrit ai konsiderohet jo shume i ndotur pasi zona nuk eshte zone industriale qe te prodhoje gaze ndotese per ajrin. Ndotja e ajrit vjen vetem nga pluhurat qe krijohen nga levizja e automjeteve apo dhe aktivitate te tjera njerezore.Temperatura mesatare vjetor eështë 16°C.Sasia mesatare e reshjeve është 1297mm. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit 57m.Rrethi I Tiranes ka 331 ditë me diell në vit dhe këto kushtëzohen nga pozicioni gjeografik, vranësirat dhe pozicioni I vendit të matjes.Intensiteti ir rezatimit të drejtpërdrejtë i diellit është më I lartë në muajin Maj,ndërsa më I ulet në Dhjetor.Kurse vlere më e lartë në mesditë është gjatë muajit Korrik.Reshjet në Tirane kryesisht përfaqësohen nga rëniet e shiut,që kapi nshifrën 128–139 ditë reshje nëv it.Lagështia mesatare ditore e ajrit është rreth 72%. Klima e zones ka një thatësi të gjatur që varion nga 9 deri 11 javë në vite.

Ndertimi gjeologjik i rajonit

Ne ndertimin gjeologjik marrin pjese depozitime karbonatike te zones tektonike Mirdita dhe perfaqeson krhun jugperendimor te saj. Formacioni karbonatik dhe ai terrigjen ndodhen ne zonen e malit te thate dhe pjeserisht ne ultesiren e Korces.

Pershkrim i biodiversitetit ne zonen e projektit

Problemet e biodiversitetit perbejne aktualisht nder problemet me me rendesi ne rruzullin tokesor. Termi biodiversitet eshte shume kompleks dhe si i tille, zhvillimi dhe percaktimi i strategjive te pershtatshme per mbrojtjen e tij, shoqerohet me nje proces te veshtire zgjedhjesh dhe vendimmarjesh. Biodiversiteti perben teresine e llojeve dhe ekosistemeve ne nje rajon, apo ne gjithë rruzullin tokesor. ekosistemet jane te nje rendesie te vecante sepse ato perbejn bazat per ekzistenen e llojeve. Cenimi i tyre, si rezultat i aktiviteteve te ndryshme ekonomike shoqerore perben nje shqetesim per njerezit dhe studiuesit . Vlere e nje biodiversiteti te larte per njerezimin jepet para se gjithash nepermjet funksionit te tij si stabilizator i biosferes dhe si burim direkt i prodhimit.



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

Bimesia

Vendi ku do te behet ndertimi dhe do te zhvillohet aktiviteti eshte pothuajse i zhveshur nga bimesia .Rriten vetem pak shkure te vogla si dhe dushqe ku lartesia e tyre nuk i kalon 1.2 m .Ne zonen e dherave qe ne rastin tone eshte shume e vogel mbulesa nuk perfaqeson rezerva gjeologjike,rriten lule dhe bar.

Ne fshatrat perreth zones rriten edhe nje numer i konsiderueshem bimesh frutore si molle, ftonj, dardha, kumbulla etj.

Gjithashtu mund te themi se vendi i aktivitetit nuk i perket zonave te mbrojtura dhe nuk njihet si nje zone me flore dhe faun te vecante. Aktiviteti une nuk do ndikoje ne zone perreth.

1. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet qe zhvillohet shoqerohet me pasoja dhe ndikime ne mjedis, qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jone ka zgjedhur per tu zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitikiisht ndikimet e cdo operacioni te kryer.

Vleresimi i ndikimeve te mundshme si pasoje e veprimtarise behet duke u nisur nga nje sere faktoresh qe lidhen me natyren e veprimtarise, teknologjine e perdorur, menyren e funksionimit, sasine e energjise, lendet e para te perdorura dhe mbetjet e gjeneruara, te gjitha keto ne kontekstin e mjedisit fizike, biologjike dhe social-ekonomik.

Per vleresimin e ndikimeve ne mjedis te projektit u ndoqen hapat e meposhtme:

- Njohja me teknologjine qe do te perdoret
- Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore te zones dhe siperfaqes ku do zhvillohet aktiviteti

Duke analizuar natyren e te gjithe proceseve dhe format e shfaqjes se tyre, direkte ose indirekte, percaktohet qarte lloji i ndikimeve. Te gjitha ndikimet mund te minimizohen ne terma relative ku qellimi kryesor eshte mbajtja e tyre brenda siperfaqes se objektit te kerkuar dhe krijimi i kushteve natyrore per te siguruar riaktivizim te proceseve te natyres dhe rigjenerim te ekosistemit.

Shkarkime ne uje

Sistemi i furnizimit te kompleksit me uje per nevojat jetesore eshte i mbyllur, pahumbje i kontrolluar ne menyre automatike dhe praktikisht pa asnje mundesi shkarkimi ne ujerat siperfaqesore. Pjesa tjeter e ujit e rritet ujembledhes te instaluar ne kompleks depozitohet ne gropen septike qe do te ndertohet per kete qellim, ku i nenshtrohet pastrimit te herepashershem Pra gjate punes normale te aktivitetit nuk kemi shkarkime ne mjedisin uJOR prites qe e ndot ate.



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

Emetimet ne ajer

Projekti gjate fazes se ndertimit do te kete te pranishme emertime ne ajer te cilat do te jene kryesisht pluhra, me prejardhje nga levizja e lire e mjeteve ne sheshin e ndertimit, gjithashtu do te kemi edhe prani te gazrave te cilat kane po te njejten prejardhje. Duke marre parasysh fazen ndertimore dhe duke e krahasuar me projektete te po te te njejtit lloj keto emetime jane te pritshme, por duke iu referuar faktit qe keto mjete do te jene teknikisht ne gjendje te mire, te kolauduara emetimet do te jene ne nivele minimale te pranueshme. Emetimi i komponenteve te lartepemendura do te jete i kontrolluar dhe do meren masa per minimizimin e tij si pershembull sperkatja me uje, levizja e mjeteve me shpejtesi te ulet etj.

Meqenese te dy kapanonet do te kene strukture metalike rrjedhimisht ulen ndjeshem emetimet e gjeneruara nga ndertimi. Gjithesesi edhe pse do kemi emetime te pranishme edhe ne fazen e ndertimit do te merren te gjitha masat nga ana e shoqerise ndertuese, por edhe nga operatori. Keto emetime do te jene nen normat e percaktuara ne legjislacionin aktual ne fuqi gjithashtu do te meren masa te menjehershme dhe do te lajmerohen organet kompetente ne raste te ndonje avarie e cila mund te shkaktoje ndikim negativ ne mjedis.

Emetime ne ajer nga funksionimi i ketij projekti do te jene minimale, emetimet do te vijne vetem nga mjetet e transportit qe do te sjellin pulat ose qe do bejme transportin e tyre, kur te jene gati per import ose tregtim. Keto emetime do te jene minimale pasi mjetet e transportit do te jene te kolauduara konform legjislacionit ne fuqi dhe do te transportojne pulat vetem ne periudha te caktuara te vitit.

Zhurmat, vibrimet dhe aromat e pakendeshme

Duke iu referuar natyres se aktivitetit nuk kemi prani te zhurmave dhe vibrimeve si pasoje e teknologjise. Zhurma dhe vibrime te lehta do te gjenerohen vetem gjate fazes se ndertimit. Keto emetime jane nen nivelet e percaktuara ne legjislacionin aktual ne fuqi dhe totalisht te pranueshme per nga lloji i ndertimit.

Kapanonet do te kene nje hapsire te mjaftueshme dhe do te jene te pajisura me ventilatore te cilet do te bejne te mundur uljen e emetimeve te aromave. Nje faktor tjeter i cili do te ndikojte ne uljen maksimale te aromave eshte edhe pastrimi ne menyre te vazhdueshme pa perdorur detergjente qe mund te rrezikojne biodiversitetin ne mjedisin uhor prites.

Mbetjet e prodhuara

Ne kete lokal sasia ditore nga jashteqitjet e pulave eshte 1 ton ne dite. Plehu depozitohet poshte pjeses se baterise (vendqendrimi i shpendeve) ne nje sistem i cili eshte i perber nga tallashi me trashesi 5-7 cm. Gjate qendrimit per rreth 45 dite ne kete lokal plehu thahet me anen e sistemit qe eshte shtruar. Plehu i grumbulluar me ane te transportimit me kamiona perdoret me sukses per pleherimin e tokave te fermereve te zones.



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

Shfrytezimi i ketij plehu ka rendesi te madhe ne prodhimin bujqesor pasi eshte shume i pasur me fosfor, potas dhe elemente te tjere organike. Mbetje te tjera te ngurta vijne vetm nga aktiviteti i perditshem njerezor te cilat grumbullohen ne vend te posacem dhe me pas largohen per ne vendet e caktuara nga pushteti lokal.

Mbetjet te cilat do te vijne nga faza e ndertimit do te evadohen nga ana e shoqerise ndertuese edhe pse do te synohet qe mbetje te cilat mund te sherbejne per rehabilitime te ndryshme te perdoren per kete qellim.

Per sa me siper menyra e evadimit dhe perdorimit te mbetjeve ne te dyja rastet na con drejt nje menaxhimi te integruatr te tyre duke ulur keshtu riskun e qasjes se nje ndikimi negativ ne mjedis. Theksojme faktin se vendi ne te cilen do zhvillohet aktiviteti eshte ne nje largesi te konsiderueshme nga banesat apo bizneset e zones.

Ndikimet ne flore dhe ne faune

Zona ne te cilen do te zhvillohet aktivitetit është një zonë në të cilën nuk takohen elemente te flores apo faunes se rralle. Gjithashtu nga zhvillimi i ketij aktiviteti nuk kemi ndikime negative as ne flore as ne faune. Perreth kësaj zone, mund te hasim bimesi te ulet dhe barishte te ndryshme. Jashtë konturit të impjantit, zona nuk ndryshon.

Flora bëhet gjithnjë e më e larmishmë duke u larguar nga objekti. Kjo ka të bëjë me bimet e arave dhe pemët të cilat rriten në fushat rreth impjantit. Si zonë kultivon drithra, lakrën, bamjen, domaten e shumë perime të tjera. Në pemtari mund të përmëndim mollen, kumbullen, rrushin etj.

Më të pranishem janë shpendët shtëpiake dhe kafshët shtëpiakë, janë shumë të përhapur zogjtë e llojeve të ndryshme që rriten në kete zone si harabelat, cirlet, mëllenjat, gushkuqi, dallëndyshet etj, insekte e zvarranikë të llojeve të ndryshme.

Projekti nuk paraqet ndikime negative ne mjedis as ne fazen e ndertimit as ne fazen e operimit.

Ndikimet ne ekonomi

Persa i perket ndikimeve ekonomike ky projekt do te sjell efekte direkte ne punesimin e popullsise se zones, pra do te ndikojne ne rregullimin e tregutse punes si rrjedhim do te rritet edhe mireqenia e nivelit te jeteses te popullsise se zones. Ne fazen e operimit, por edhe ne fazen e ndertimit do te kete punesim te banoreve te zones.



MASAT PER ELEMENIMIN / ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

- Mbetjet e ngurta urbane që do të prodhohen ne objekt të depozitohen në vendet e përcaktuara nga NJ.Q.V, madje operatori do te vendos koshat qe keto mbetje ti ndaje nga karakteri i tyre.
- Do te sistemohet dhe do te rehabilitohet sipërfaqja pas ndertimit dhe gjate operimit te aktivitetit.
- Automjetet e transportit te qarkullojne me shpejtesi te ulet te menyre qe te mos krijohen vibrime.
- Ne pjesen e mbetur te sipërfaqes se lire mbas ndertimit operatori duhet te mbjelle sa me shume peme per te krijuar nje pamje vizuale te bukur por edhe per te ulur ndikim ne mjedis edhe pse nga te gjitha gjykamit e bera ato jane ne nivele te ulta dhe totalisht te pranueshme.
- Operatori duhet dhe do te jete I kujdeshem ne mirefunksionimin e gropes dekantuese qe do te ndertoje per llogari te aktivitetit.
- Duhet dhe do te kryeje monitorimin e vazhdueshem lidhur me shkarkime ne uje, ajer, toke per te qene gjithmon i informuar.
- Masat per mbrojtjen kunder zjarrit te cilat jane shume te rëndesishme duke qene se eshte zone e mbrojtur ato jane parashikuar ne projekt dhe jane si me poshte:
 - Pozicionimi i shenjave ne vende te dukshme dhe vendosja e instruksioneve per veprimet qe duhet te kryeje personeli ne rast zjarri.
 - Pozicionimi i shenjave qe paraqesin pozicionet e sharresve te zjarrit,rruget e largimit dhe daljet e emergjnces
 - Largimin e materialeve te ndezshme nga ambjentet e godines dhe vendosjen e tyre ne vende te sigurta per parandalimin e transmetimit te zjarrit
 - Mbajtje e lire e rrugeve te largimit
 - Mirembajtje dhe kontroll i vazhdueshem i instalimeve elektrike ne perputhje me rregullat perkatese per instalime te tilla.
 - Duke marre ne konsiderate karakteristikat e nderteses si dhe destinacionin e saj jane perdorur substanca shuarese si me poshte:
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidtrante te jashtem
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidtrante te brendshem
 - Shuares portable ne te gjitha pozicionet te cilat parashikohen ne project.



Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune

➤ Detyrat e subjektit qe do te zhvilloje aktivitetin:

- Do te punesohen punonjes qe e kane mbushur moshen per pune dhe specialist te profesioneve qe kerkohen.
- Do te punesohen punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion.
- Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike do te instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.
- Punonjesit do te pajisjen me mjete mbrojtese si dhe unifromat perkatese,
- Do te instruktohen punonjesit ne menyre periodike.

➤ Detyrat e punonjesve:

- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.
- Te kontrolloje gjendjen teknike te pajisjeve ne perdorim para fillimit te punes dhe pasi konstaton gjendjen e rregullt te tyre fillon punen.
- Kur konstaton difekt dhe nuk eshte ne gjendje ta eliminoje ndalon punen dhe ve ne dijeni pergjegjesin me te afert.
- Te perdore mjetet individuale te mbrojtjes gjate punes.



Eko-Studio-Projekt Sh.p.k.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

KONKLUZIONE

- Zhvillimi I ketij aktiviteti nuk shoqerohet me lindjen e ndonje impakti negative ne mjedis. Jane marre te gjitha masat si nga ana teknologjike ashtu edhe nga ana administrative per te evidentuar ndonje impact te mundshem.
- Niveli i zhurmave eshte ne parametra normal dhe ne nivele të pranueshme. Nuk eshte shqetesues per banoret e zones edhe pse ata jane ne nje largesi te konsiderueshme.
- Gjatë operimit nuk do te kete shkarkime me karaktere ndotes as ne ajer as ne uje dhe as ne toke. Mbetjet do te evadohen ashtu sic e parashikon legjislacioni aktual ne fuqi.
- Gjatë procesit të ngarkim – shkarkimit do meren masat qe mjetet te ruajne shpejtesine e lejuar per te evituar ngritjen e pluhurave, gjithashtu do te laget siperfaqja pas largimit te mjeteve. Eshte e rendesishme te theksohet fakti se keto makineri do te kryejne kete sherbim ne periudha te caktuara te vitit.
- Per nje pune sa me optimale duhet te zbatohen rregullat e sigurimit teknik ne pune dhe te mbahet nje kujdes shume i vecante lidhur me kushtet higjeno sanitare.

REKOMANDIME

- Te kontrollohen, pastrohen dhe mirembahen kanalet kulluese ne territor.
- Te behet gjelberimi i mjedisit duke shtuar siperfaqete gjelberta ne perimetrin rrethues te godines, gjithashtu edhe ne siperfaqe e lira brenda territorit te kompanise.
- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik, si dhe me efektet e ndryshme qe mund te lindin nga zhvillimi i ketij aktiviteti.
- Te largohen te gjitha mbetjet ngurta qe krijohen si rezultat i zhvillimit dhe aktivitetit njerezor ne vendet e percaktuara nga pushteti lokal.
- Te mbahet kontakt i vazhdueshem me ARM e rrethit dhe te dergohet informacion periodik per shkarkimet ne ajer, uje dhe toke.
- Te pastrohet ne menyre periodike gropa septike.